



Eja, Më Ndiq- Veprimtaritë

Për mbrëmjen e shtëpisë ose studimin
e shkrimeve të shenjta – ose thjesht për argëtim!


1-7 Korrik

Punëdore për Planin e Lumturisë

PËR KAPITUJT TEK ALMA 17-22

Aaroni dhe Amoni, që të dy, dhanë mësim rreth planit të Atit Qiellor për lumturinë. Ata e quajtën atë plani i shëlbimit (shih tek Alma 18:36-39 dhe Alma 22). Kthehu te faqja 12 për të bërë punëdoren tënde për planin e lumturisë.

Për fëmijët më të vegjël: Gjeni një fotografi të fëmijës suaj kur ishte foshnjë. Vini në dukje mënyrat se si është rritur që nga koha kur ishte foshnjë. Më pas flisni për faktin se ne jemi në tokë që të rritemi si pjesë e planit të Atit Qiellor.



8-14 Korrik

Mjete në Duart e Perëndisë

PËR KAPITUJT TEK ALMA 23-29

Amoni u tha vëllezërve të tij: “Ne u bëmë mjete në duart e Perëndisë për të plotësuar këtë punë të madhe” (Alma 26:3). Mblidh instrumente që mund t’i përdorësh për të bërë muzikë. Më pas krijo ritme dhe këngë. Ashtu si ne përdorim instrumente për të bërë muzikë, Perëndia mund të na përdorë që të ndihmojmë për të ngritur Kishën e Jezu Krishtit.

Për fëmijët më të vegjël: Bëni një udhë të thjeshtë me pengesa. Ushtrohuni se si të kaloni përmes saj. Më pas hiqini pengesat dhe provojeni përsëri. Shpjegoni se mbreti i lamanitëve i hoqi pengesat kur Amoni dhe vëllezërit e tij donin të jepnin mësim ungjillin në vendin e tij (Alma 23:3).


15-21 Korrik

Kujtuesi me Lojën me Karrige dhe Muzikë

PËR KAPITUJT TEK ALMA 30-31

Alma dha mësim që “të gjitha gjërat tregojnë se ka një Perëndi” (Alma 30:44). Kjo do të thotë se gjithçka që krijoi Perëndia, mund të na e kujtojë Atë. Vendosi karriget në një rreth ku ka mjaft karrige për të gjithë përveç një personi. Bëj që dikush të vërë muzikë dhe të zgjedhë se kur ta ndalojë atë. Kur të ndalet muzika, gjithsecili ulet në një karrige. Personi që nuk ka karrige, tregon një gjë që i kujton Perëndinë. Vazhdo derisa gjithsecili të ketë rast për të marrë pjesë.

Për fëmijët më të vegjël: Ecni përreth shtëpisë suaj ose jashtë. Kërkoni gjëra që ju ndihmojnë të ndiheni të lumtur dhe ju kujtojnë Atin Qiellor.



ILLUSTRIMET NGA KATY DOORILL



22-28 Korrik

Rritja e Dëshmisë Sate

PËR KAPITUJT TEK ALMA 32-35

Alma dha mësim se kur ti e dëgjon fjalën e Perëndisë dhe bën gjëra që tregojnë besimin tënd, dëshmia jote rritet, ashtu si një pemë (shih tek Alma 32:37). Vizato gjëra që mund t’i bësh për ta ndihmuar një pemë të rritet, si për shembull t’i japësh ujë dhe dritë dielli. Më pas vizato gjëra që mund t’i bësh për ta ndihmuar dëshminë tënde të rritet, si për shembull të shkosh në kishë dhe të lutesh.

Për fëmijë më të vegjël: Këndoni këngën “Besimi” (*Libri i Këngëve të Fëmijëve*, f. 50-51). Teksa këndon, bëni veprime për të treguar një farë që po rritet duke u bërë [një pemë] e madhe dhe e gjatë. Flisni rreth rritjes së dëshmisë suaj.